

URDHËR
Nr.13, datë 8.4.2005

PËR MARRJEN E MASAVE PËR NDALIMIN E KËMBIMIT ILEGAL VALUTOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 8 pika 9 dhe nenit 13 të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 "Për policinë bashkiake e të komunës", të nenit 14 të ligjit nr.8610 datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.8553, datë 21.11.1999 "Për Policinë e Shtetit dhe të nenit 49 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e ushtrimit në mënyrë të paligjshme të tregtimit dhe këmbimit valutor,

URDHËROJMË:

1. Të merren masa për ndalimin e ushtrimit të këmbimit valutor të palicencuar në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi ky aktivitet sjellë shmangie të detyrimeve fiskale, kryerjen e transaksioneve ilegale valutore jashtë sistemit bankar, favorizim të elementeve kriminale për këmbim të parave të rrjedhura nga krimet, mashtrime, grabitje, vjedhje, të klientëve dhe vetë këmbyesve ilegalë, qarkullim të monedhave të falsifikuara dhe ushtrim të aktivitetit të paligjshëm në ambiente publike.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Policia Tatimore), policitë bashkiake dhe të komunave të koordinojnë veprimet për parandalimin, ndërprerjen dhe procedimin ligjor, administrativ ose penal të çdo personi që ushtron veprimtarinë e këmbimit të palicencuar valutor në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Përfaqësuesit e grupit teknik ndërinstitucional të punës për parandalimin e pastrimit të parave programojnë dhe të koordinojnë masat ndërmjet institucioneve me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e ushtrimit në mënyrë të paligjshëm të tregtimit dhe këmbimit valutor.

4. Strukturat e përcaktuara në pikën 6 të këtij urdhri të raportojnë në mënyrë periodike te titullarët e institucioneve dhe nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre të informojnë grupin teknik ndërinstitucional të punës për parandalimin e pastrimit të parave.

5. Grupi teknik ndërinstitucional i punës informon titullarët e institucioneve bashkërenduese dhe kryetarin e Komitetit Kombëtar të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

6. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria kundër Krimin të Organizuar në Shërbimin Informativ Shtetëror dhe policitë bashkiake e të komunave në vend.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

MINISTRI I RENDIT PUBLIK
Igli Toska

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR DHE
DECENTRALIZIMIT

Ben BLUSHI
DREJTORI I SHËRBIMIT INFORMATIV
SHTETËROR
Bahri Shaqiri